



Prishtinë, 19.12.2008  
Kodi i ZRRE-së: V\_140\_2008

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 15.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitave të nenit 17 të Licencës për Shpërndarje të ngrohjes qendrore dhënë NQ Gjakova SH.A.
3. Kërkesës së NQ Gjakova SH.A për miratim të Kodit të Sjelljes dhe Etikës të datës 27 nëntor 2008,

**Në mbledhjen e mbajtur më 19 dhjetor 2008 nxori këtë:**

### VENDIM

#### I. APROVOHET Kodi i Sjelljes dhe Etikës i NQ Gjakova SH.A.

#### Arsyetim

1. Bazuar në përgjegjësitë që dalin nga neni 17 i Licencës së Shpërndarjes së ngrohjes qendrore dhënë NQ Gjakova SH.A, i licencuari obligohet që të përgatis Kodin e Sjelljes dhe Etikës, dhe të njëjtin ta dërgojë në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) për aprovim.
2. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 27.11.2008, nëpërmes postës së rregullt dhe postës elektronike, ka pranuar kërkesën e të licencuarit NQ Gjakova SH.A. për miratim të Kodit të Sjelljes dhe Etikës.
3. Gjatë analizimit të Kodit, ZRRE ka vlerësuar se i njëjti përmban dispozita që mbulojnë detyrimet e stafit të të licencuarit lidhur me konfidencialitetin, konfliktin e interesave, dispozita që përcaktojnë shkeljet e detyrave të punës dhe dispozita tjera, andaj aprovon Kodin në fjalë si të tillë.
4. Në përputhje me nenin 17.4 të Licencës së Shpërndarjes së ngrohjes qendrore, **obligohet** i licencuari që pas pranimit të këtij vendimi menjëherë ta publikojë këtë Kod në faqen e tij elektronike.
5. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis versioneve të ndryshme, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
6. Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
ENERGY REGULATORY OFFICE  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

**Këshillë juridike:** Kundër këtij Vendimi palët e pakënaqura mund të iniciojnë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente në Prishtinë brenda (14) ditëve nga pranimi i Vendimit.

Bashkangjitur: Versioni i aprovuar i Kodit të Sjelljes dhe Etikës.

Bordi i ZRRE-së

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Dr. Nysret Avdiu, anëtar